



MANUAL INFORMATIV PËR PROJEKTIN “QYTETE TË SIGURTA PËR GRATË DHE VAJZAT” RAPORTI MES NDRIÇIMIT, SIGURISË DHE KRIMIT

Projekti “**Qytete të sigurta për gratë dhe vajzat**”, lindi si një nevojë për shkak të një prej problemeve më të mëdha që shqetëson sot komunitetin e lagjes nr.12 dhe nr.16, në qytetin e Durrësit (“Zona e Stadiumit”) - ndriçimi i pamjaftueshëm në rrugë. Në rrugën “Abaz Çelkupa” dhe “Hysen Kërtusha”, ndriçimi është shumë i dobët dhe pothuajse mungon. Ndërsa në rrugën “Mujo Ulqinako” ndriçimi mungon fare.

Qëllimi i projektit është përmirësimi i sistemit të ndriçimit në lagjet nr.12 dhe nr.16, të qytetit të Durrësit, duke i kthyer ato në hapësira të sigurta publike për komunitetin dhe kryesisht për vajzat e gratë. Ndër objektivat specifike që synohen të realizohen janë: i) *Informimi dhe nxitja e komunitetit të të dy gjinive në lagjet numër 12 dhe 16, për të advokuar në zgjidhjen e problemit;* ii) *nxitja e llogaridhënies së anëtarëve të Këshillit Bashkiak për rastin dhe adresimin përmes tyre në buxhetin e bashkisë, për marrjen e masave;* iii) *ndërrhyrje urgjente për përmirësimin e sistemit të ndriçimit në rrugën “Mujo Ulqinaku”, “Abaz Çelkupa” dhe “Hysen Kërtusha”, si edhe sugjerimin e rrugëve të tjera që paraqesin karakteristika të ngjashme.* Mjeti kryesor me të cilin ato do të advokojnë është peticioni drejtuar Bashkisë Durrës, për përmirësimin e menjëhershëm të ndriçimit në zonë. Përmes Aleancës së Grave Këshilltare në Këshillin Bashkiak Durrës do të llobohet që zgjidhja e problemit të adresohet në buxhetin e Bashkisë Durrës.

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Bazuar në “Raportin mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri”¹ në vitin 2018, përgatitur nga IDRA Research & Consulting, në bashkëpunim me UN Women, ku është marrë në studim zona e Stadiumit në qytetin e Durrësit, ka rezultuar se gratë dhe vajzat shqiptare nuk janë të sigurta në hapësirat publike. Diskutimet nëpër fokus-grupe treguan që një ndër faktorët që i bëjnë gratë të ndihen të pasigurta dhe kontribuojnë në ngacmimin në publik, janë ndriçimi i pamjaftueshëm në rrugë dhe/ose përpara shtëpive, sidomos gjatë mbrëmjeve dhe netëve, rrugicat pa ndriçim, pa monitorim, mos patrullimi nga policia, grupet e burrave dhe djemve që përdorin alkool dhe drogë.

Ndërkohë, edhe studime të kryera në SHBA dhe Mbretërinë e Bashkuar tregojnë se ka një lidhje mes ndriçimit dhe kryerjes së aktiviteteve kriminale të të gjithë llojeve duke futur këtu vrasjet, grabitjet, vjedhjet, përdhunimet etj. Një pjesë shumë e madhe e tyre ndodhin natën dhe kjo jo rastësisht, por sepse në këtë mënyrë agresorët kanë mundësi të mos identifikohen nga viktimat ose dëshmitarë të mundshëm, apo kanë edhe në rast se identifikohen kanë mundësi të largohen nën hijen e natës. Në një studim të kryer në vitin 2018 në qytetin e Nju Jorkut² ku një pjesë e zonave me nivele të larta krimi u ndriçuan dhe një pjesë jo për efekt studimi u vu re se atje ku niveli i ndriçimit u rrit gjithë krimet e sipërpërmendura u ulën me 39% që është një rënie e konsiderueshme. Në këtë mënyrë ndriçimi në qendrat e banuara rezulton një faktor frenues dhe kufizues i këtyre krimeve. Kjo nuk do të thotë se ndriçimi i vetëm ndikon në parandalimin e krimit, por kur ai ndërthuret me punën e duhur të strukturave të rendit dhe me bashkëpunimin e komunitetit me strukturat e rendit atëherë ka rezultate të këndshme. Kjo sepse ka studime të tjera

¹ Raporti “Mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri”, IDRA Research & Consulting, UN Women, 2018.

² Major study finds outdoor lighting cut crime by 39%: <https://www.ledsmagazine.com/architectural-lighting/article/16701511/major-study-finds-outdoor-lighting-cut-crime-by-39>

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



që thonë se jo gjithmonë ndriçimi i vetëm do të ulë nivelin e krimit në komunitet. Niveli i këtij të fundit rezulton i ulur vetëm kur ka një ndërthurje të masave në lidhje me të.

Në këtë pikë rezulton me vend përfshirja e pushtetit vendor në rritjen e nivelit të ndriçimit dhe mirëmbajtjen e tij si një mënyrë për të patur komunitete më të sigurta. Bazuar në ligjin nr. 139/2015, për “Vetëqeverisjen Vendore”, në Nenin 23, “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, në pikën numër 5 për ndriçimin e mjediseve publike përcakton qartë bashkinë si institucionin kompetent për marrjen e masave. Gjithashtu bazuar në Planin e veprimit për barazinë gjinore në Bashkinë Durrës 2018-2020 një ndër objektivat specifike për qëllimin strategjik: “Reduktimi i stereotipeve dhe pabarazive gjinore, përmes promovimit të parimit të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, në aksesin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara, është: “Të transformohen lagjet e Durrësit në hapësira të sigurta publike për gratë, të rejtat, vajzat, djemtë, të rinjtë dhe burrat e të gjitha grupeve shoqërore”.

Gjithashtu perceptimi i qytetarëve për ndriçimin e qendrave të banuara lidhet drejtpërdrejt me kompetencën e zyrtarëve publikë për t’i shërbyer komunitetit. Atje ku ndriçimi ka qenë më i mirë atëherë perceptimi i qytetarit për punën e zyrtarëve publikë ka qenë më i favorshëm duke e përshkruar qeverisjen si të besueshme dhe e anasjella atëherë kur ka patur laguna në këtë drejtim atëherë qytetarët kanë patur përshtypjen se zyrtarët publikë nuk janë në krye të detyrës dhe nuk po e bëjnë atë me kompetencën që duhet. Në këtë kuadër lind nevoja për informimin dhe nxitjen e komunitetit të të dy gjinive në lagjet numër 12 dhe 16, për të advokuar në zgjidhjen e problemit në mënyrë që të nxitet llogaridhënia e anëtarëve të Këshillit Bashkiak për rastin konkret dhe adresimin përmes tyre në buxhetin e bashkisë, për marrjen e masave për ndërhyrje urgjente për përmirësimin e sistemit të ndriçimit në rrugën “Mujo Ulqinaku”, “Abaz Çelkupa” dhe “Hysen Kërtusha”. Prandaj takimet me komunitetin dhe diskutimet me gjimnazistët synojnë të nxisin raportimet e ngacmimeve seksuale në organet vendore dhe ligjzbatuese. U pa e nevojshme

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC




Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



marrja e perceptimit të nxënësve në 4 gjimnazet e zonës së stadiumit (Naim Frashëri, Leonik Tomeo, Benardina Qerraxhia dhe Hysen Çela), në vlerësimin e sigurisë në këto rrugë, se si mund të rritet siguria e rrugëve për to, ku mund të raportojnë rastet e ngacmimeve seksuale, dhunës dhe se si mund t'i adresohen pushtetit lokal për problematikat në komunitet. Në pyetësor morën pjesë 100 nxënës, 61% femra dhe 39% meshkuj. Si një përmbledhje e shkurtër e rezultateve të pyetësorit mund të vihen re tre gjëra me rëndësi:

Së pari është fakti se shumica dërrmuese është e mendimit se ndriçimi i rrugëve është pak ose aspak i mjaftueshëm pothuajse pak më pak se gjysma shprehen se ngacmime me sfond seksual apo grabitje ndodhin për këtë shkak ku respektivisht 45.2% janë shprehur se kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së ndriçimit, 48.5% për shkak të pranisë në zonë të individëve problematikë të zonës dhe 6.3% janë shprehur se kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit policor në zonë.




Së dyti është fakti se shumica dërrmuese 79% e të anketuarve mendojnë se adresimi i problemit me anë të një peticioni për mungesën e ndriçimit në bashkisë do të sjellë zgjidhje në përmirësim të situatës dhe 21% mendojnë se nuk do të sjellë zgjidhje në përmirësim.

Financuar nga LevizAlbania




Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC





Dhe së treti vihet re se njoftimi në organet e rendit si në rastet e ngacmimeve ashtu dhe grabitjeve mbetet në nivele shumë të ulëta, vetëm 6% të rasteve kjo është raportuar në polici dhe në 94% nuk është raportuar



Ajo mund të thuhet si përfundim është se ndriçimi cilësohet si nga ekspertë të sigurisë publike ashtu edhe private një element i shtuar sigurie i cili edhe kur nuk e parandalon krimin e rrit nivelin e zbulueshmërisë së krimit në komunitet duke ndihmuar forcat e rendit dhe në këtë mënyrë rrit nivelin e sigurisë, përmirëson perceptimin për zyrtarët publik dhe i bën qytetarët të ndihen më të sigurtë.

**Ky material u realizua në kuadër të projektit "Qytete të sigurta për gratë dhe vajzat" zbatuar nga Livia Kreko, me mbështetjen financiare të LevizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkujnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.*

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC